

**RAPORT MBI  
KONFERENCËN RAJONALE PARLAMENTARE PËR NDIHMË SHITËTËRORE, KONKURRENCË  
DHE INVESTIME TË HUAJA DIREKTE**

***“ROLI I PARLAMENTEVE NË PROMOVIMIN E INVESTIMEVE DHE KONKURRENCËS NË  
BALLKANIN PERËNDIMOR”***



3 dhe 4 mars, 2014  
Beograd, Republika e Serbisë

## 1. *Përmbledhje*

**Rreth 100 deputet dhe staf parlamentar nga 8 parlamente të Ballkanit dhe nga parlamenti i Skocisë, së bashku me përfaqësues nga biznes sektori, agjenci për promovim të investimeve, dhoma të tregtisë dhe shoqata të punëdhënësve, u mbledhën në një konferencë rajonale në Beograd, Serbi më 3 dhe 4 mars. Qëllimi i konferencës ishte diskutimi mbi “Rolin e parlamenteve në promovimin e investimeve dhe konkurrencës në Ballkanin perëndimor”.**

Konferenca u hap nga zonja Vesna Kovaç, zëvendës kryetarja e Kuvendit të Republikës së Serbisë, e cila tha:

“Temat që do të diskutohen në konferencë kanë rëndësi të posaçme për të gjitha vendet e rajonit. Investimet e huaja janë burim i rritjes industriale, modernizimit, rritjes së prodhimit, eksportit dhe të ardhurave. Kjo konferencë gjithashtu do të merret me një temë tjetër shumë të rëndësishme, e cila është ndihma shtetërore. Sa ndikon ndihma shtetërore tek politikatat e konkurrencës? Ndhma shtetërore duhet të jetë mirë e menaxhuar që të jetë efektive. Znj. Kovaç theksoi se:

“Përforcimi i roleve të parlamentit në rajonin tonë nënkupton përforcimin e roleve të komisioneve parlamentare, që janë shumë të rëndësishme në krijimin e politikave ekonomike. Roli i komisioneve nuk është vetëm të pranon ligjet e propozuara por gjithashtu të përmirëson cilësinë e tyre.”

Gjatë konferencës dyditore panelistët dhe pjesëmarrësit shkëmbyen këndvështrime dhe argumente mbi “Promovim të investimeve dhe konkurrencës nëpërmjet punës së Parlamentit”, “Zhvillim të politikave për tërheqje të investimeve të huaja direkte dhe përforcimin e konkurrencës” dhe “Politikat për ndihmë shtetërore dhe subvencionet për investuesit në rajonin e Ballkanit Perëndimor para hyrjes në BE”.

Një sërë çështjesh u përmendën nga deputetët dhe pjesëmarrësit. Z. Radojko Obradović, deputet nga Kuvendi Kombëtar i Serbisë vuri në pah disa çështje:

“Çështje me të cilën merremi sot, mes tjerash është: a duhet të subvencionojmë investuesit, dhe nëse përgjigja është po, atëherë cilët duhet subvencionuar? A është e përshtatshme politika për ndihmë shtetërore dhe subvencione për investuesit? A është diçka që mund të zbatohet vetëm në këtë rajon ose edhe jashtë rajonit? A ndryshojnë politikatat tona dhe qëndrimet ndaj ndihmës shtetërore varësisht nga situata ekonomike? Dhe në fund: a ndikojnë këto ndryshime tek sjellja e përgjithshme dhe tek marrëdhëniet tona?”

Anëtarët e biznes bashkësisë, dhomave të tregtisë, agjencive për tërheqje të investuesve dhe shoqatave të pjesëmarrësve nga rajoni shprehën këndvështrimin e tyre si panelist dhe pjesëmarrës në konferencë.

z. Aleksandar Damjanović, deputet nga Mali i Zi tha se “parlamenti ka rol të dyfishtë në krijimin e një mjedisi të shëndoshë për bizneset. Ka rol të drejtpërdrejtë në krijimin e ligjeve të posaçme që duhet të përmirësojnë klimën për investime, dhe rol të jo-drejtpërdrejtë ku duhet të ndjekin ligjet e përgatitura nga qeveria nga fusha fiskale dhe ajo e investimeve.”

Një prej konkluzioneve kyçe nga konferenca ishte se parlamentet duhet të zhvillojnë më tej kapacitetet e tyre për mbikëqyrje nëpërmjet shpërndarjes dhe miratimit të praktikave më të mira për mbikëqyrje të politikave për ndihmë shtetërore, konkurrencë dhe investimeve të huaja direkte dhe kërkuan zhvillim të mëtutjeshëm të kulturës së mbikëqyrjes me seanca të rregullta vjetore për mbikëqyrje. Për më shumë konkluzione dhe rekomandime nga konferenca, klikoni këtu.

Kjo ishte konferenca e parë e organizuar nga Westminster Fondacioni për Demokraci (WFD) në vitin 2014, si pjesë e bashkëpunimit me Rrjetin e Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financa dhe Integrim Evropian të Ballkanit Perëndimor. Konferenca e rendit do të mbulon temën e mbikëqyrjes së politikave rajonale për energji dhe investime energjetike dhe do të mbahet në vjeshtë të vitit 2014, në Mal të Zi.

## Konkluzione dhe rekomandime nga konferenca

Konkluzionet dhe rekomandimet nga konferenca rajonale mbi ***“Roli i parlamenteve në promovimin e investimeve dhe konkurrencës në Ballkanin Perëndimor”*** janë të ndara në tre fusha kyçe.

- A. Roli i parlamenteve**
- B. Rekomandimet e Rrjetit**
- C. Kapaciteti i parlamenteve për të zhvilluar mbikëqyrje të politikave për ndihmë shtetërore, konkurrencë dhe tërheqje të investimeve.**
  - A. Parlamentet kanë tre role kyçe në promovimin e investimeve dhe konkurrencës në Ballkanin Perëndimor:**
    1. Gjetja e zgjedhjeve ligjore për promovim dhe tërheqje të investimeve dhe përmirësim të konkurrencës
    2. Vëzhgim të zbatimit të politikave për promovim dhe tërheqje të investimeve dhe përmirësim të konkurrencës
    3. Sigurim të buxhetit për aktiviteteve për tërheqje të investimeve dhe përmirësim të konkurrencës



# NPC

Network of Parliamentary Committees  
on Economy Finance and European  
integration of Western Balkans



WESTMINSTER  
FOUNDATION FOR  
DEMOCRACY

## **B. Rekomandime të Rrjetit të Komisioneve Parlamentare**

1. Rrjeti njeh rëndësinë e politikave për tërheqje të investimeve dhe rolin e parlamenteve në promovimin e investimeve dhe konkurrencës në Ballkanin Perëndimor.
2. Parlamentet inkurajohen të përfshijnë biznes bashkësinë, dhomat e tregtisë, sindikatat e punëdhënësve, investuesit, shoqatën civile dhe aktorë tjerë joqeveritar në mbikëqyrjen e politikave mbi ndihmën shtetërore, konkurrencën dhe IHD-të.
3. Rrjeti inkurajon parlamentet të përfshihen në diskutime mbi zhvillimin e strategjive rajonale ekonomike, që mund të zhvillohen nga institucionet dhe iniciativat relevante rajonale.
4. Rrjeti inkurajon zhvillimin e analizave të kostove dhe përfitimeve të legjislaturës në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që rregullon përmirësimin e përgjithshëm të biznes mjedisit.
5. Rrjeti rekomandon zhvillimin e analizave për ndikimin e politikave të ndihmës shtetërore në Ballkanin perëndimor dhe ta ndan atë me komisionet që janë pjesë e Rrjetit.

## **C. Zhvillimi i kapaciteteve të parlamenteve për mbikëqyrje:**

1. Rrjeti inkurajon parlamentet që të shpërndajnë dhe miratojnë praktikat më të mira mbi mbikëqyrjen e politikave për ndihmë shtetërore dhe tërheqje të IHD-ve.
2. Rrjeti inkurajon parlamentet dhe komisionet parlamentare të zhvillojnë nj kulturë të mbikëqyrjes me seanca të rregullta vjetore për mbikëqyrje të zbatimit politikave për ndihmë shtetërore dhe IHD.
3. Rrjeti duhet të zhvillojë më shumë trajnime për stafin parlamentar, me qëllim që ato të pajisen me njohuritë dhe veglat e nevojshme për përkrahje të deputetëve në mbikëqyrjen e politikave të ndihmës shtetërore, investimeve dhe konkurrencës.

**Konferenca Rajonale Parlamentare mbi Ndihmën Shtetërore, Konkurrencën dhe Investimet e Huaja Direkte**

***"Roli i parlamenteve në promovimin e investimeve dhe konkurrencës në Ballkanin Perëndimor"***

**3-4 mars 2014**

**Beograd, Serbi**

**2 mars 2014**

Arritja e pjesëmarrësve në hotel Metropol Palace në Beograd

**3 mars 2014**

**09:00 – 10:00**

Regjistrimi i pjesëmarrësve

**10:00 – 10:15**

**Fjalimi hyrës,**

Nënkryetarja e parlamentit të Republikës së Serbisë, znj. Vesna Kovaç

**10:15 – 12:15**

**Paneli 1: *"Promovimi i investimeve dhe konkurrencës nëpërmjet punës së parlamentit. Zgjedhje legislative për promovimin dhe tërheqjen e investimeve dhe konkurrencës "***

z. Aleksandar Damjanovic, Deputet në Parlamentin e Malit të Zi, Kryetar i Këshillit për ekonomi, financa dhe buxhet;

z. Ervin Koçi, Deputet në Parlamentin e Shqipërisë, Anëtar i Këshillit për Ekonomi dhe financa; z. Murdo Fraser, anëtar i parlamentit skocez, Kryetar i Këshillit për ekonomi, energjetikë dhe turizëm;

z. Vladimir Marinković, Deputet në Parlamentin e Republikës së Serbisë, Kryetar i bordit të NPC

**12:15 – 13:30**

Drekë

**13:30 – 15:30**

**Paneli 2: *"Paraqitja e politikave për tërheqje të investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe përforcimin e konkurrencës. Dispozita që rregullojnë punën e agjencisë për investim në punë"***

znj. Jasmina Roskiç, Ministria për tregti të jashtme dhe të brendshme, dhe telekomunikacion të Republikës së Serbisë. Drejtuese e departamentit për marrëveshje për huamarrje, nxitje dhe mbrojtje të investimeve, koncesione dhe tregti të jashtme me mallra të kontrolluara;

z. Vasko Karangeleski, KA Group Consulting, Drejtor; *Maqedoni*

znj. Jelica Grujiç, Drejtore e Agjencisë për avancim të investimeve të huaja në Bosnjë dhe Hercegovinë (FIPA);

**15:30 – 15:45**

Pauza për kafe

**15:45 – 16:00**

**Konkluzionet e ditës së parë**

z. Emil Atanasovski, Westminster Fondacioni për Demokraci, Menaxher i programit për Ballkanin Perëndimor

**4 mars 2014**

- 09:00 – 10:00** Regjistrimi i pjesëmarrësve për ditën e dytë
- 10:00 – 10:05** Hyrje në ditën e dytë, Vladimir Marinković – kryesues i bordit të NPC Rrjetit të këshillave parlamentar
- 10:05 – 12:00** **Paneli 3: “Politikat e ndihmës shtetërore dhe subvencionet e investitorëve në Ballkanin Perëndimor. Qëndrueshmëria e ndihmës momentale shtetërore dhe subvencionet, duke marr parasysh aderimin në BE ”Implikimet në të ardhmen ”**
- znj. Andrijana Çurçiç, Ministria e financave të Republikës së Serbisë, Drejtuese e departamentit për kontroll të ndihmës shtetërore;
- z. Radojko Obradović, Deputet në Parlamentin e Republikës së Serbisë, Zëvendës Kryetar i Departamentit për financa, buxhet republikan dhe kontroll të shpenzimeve të mjeteve publike;
- znj. Bisera Turković, Lëvizja evropiane në Mal të Zi, Sekretar i përgjithshëm;
- z. Aleksandar Stojanovic, Agjencia për investime të huaja dhe promovimin e eksportit të Republikës së Serbisë (SIEPA), Ndihmës i drejtorit për promovim të eksportit;
- z. Jovan Todorov, Komisioni për mbrojtje të konkurrencës në Republikën e Maqedonisë, drejtues i Sektorit për Ndihmë Shtetërore.
- 12:00 – 13:00** Drekë
- Paneli 4: “Promovimi i investimeve dhe konkurrencës nëpërmjet përforcimit të bashkëpunimit mes odave ekonomike, këshillave parlamentar dhe agjencive shtetërore. Mekanizmat dhe veglat e bashkëpunimit për promovimin dhe tërheqjen të investimeve dhe konkurrencës”**
- z. Dejan Damjanović, ReAktiv registry solutions, Drejtor; Maqedoni
- z. Dushan Korunoski, Sindikata e Punëdhënësve të Serbisë, Sekretar i përgjithshëm;
- z. Jovan Tegovski, Qendra Rajonale për bashkëpunim (RCC), Analist i lartë i politikave
- znj. Fabiola Duro, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë, Shefe e kabinetit.
- 15:00 – 15:15** Pauzë për kafe
- 15:15 – 15:30** **Shqyrtim i konkluzioneve të secilit panel**
- z. Emil Atanasovski, Vestminster Fondacioni për Demokraci, Menaxher i programit për Ballkanin Perëndimor
- 15:30 – 16:00** **Rekomandime dhe konkluzione të konferencës**
- z. Emil Atanasovski, Vestminster Fondacioni për Demokraci, Menaxher i programit për Ballkanin Perëndimor
- z. Vladimir Marinković, Deputet në Parlamentin e Republikës së Serbisë dhe kryetar aktual i bordit të rrjetit;
- 16:00 – 16.15** Mbyllja e konferencës dhe dorëzimi i kryesimit më bordin e rrjetit
- z. Vladimir Marinković, Deputet në Parlamentin e Republikës së Serbisë dhe kryetar aktual i bordit të rrjetit;
- g. Aleksandar Damjanović, Deputet në Parlamentin e Malit të Zi dhe kryetar i ardhshëm i bordit të rrjetit.

### Pjesëmarrës të konferencës

Emri	Mbiemri	Shteti	Roli
Ervin	Koci	Shqipëria	NPC bord + Panel 1
Anastas	Angjeli	Shqipëria	Ekonomi
Liljana	Elmazi	Shqipëria	Ekonomi
Andrea	Marto	Shqipëria	Ekonomi
Idlir	Gjata	Shqipëria	Staf
Danijela	Martinovic	BH	NPC bord
Bosko	Tomic	BH	Ekonomi
Krunoslav	Vrdoljak	BH	Ekonomi
Mladen	Ivancic	BH	Ekonomi
Azra	Hadziahmetovic	BH	Ekonomi
Halid	Genjac	BH	EU
Mira	Grgic	Federata BH	NPC bord
Omer	Vatric	Federata BH	Politika ekonomike dhe fiskale
Liljana	Zovko	Federata BH	Politika ekonomike dhe fiskale
Mirsad	Zaimovic	Federata BH	Politika ekonomike dhe fiskale
Sead	Dizdarevic	Federata BH	EU
Almedina	Bulic	Federata BH	Staf
Teuta	Sahatqija	Kosova	Ekonomi
Fikrim	Damka	Kosova	Ekonomi
Hashim	Deshishku	Kosova	Ekonomi
Ali	Sadriu	Kosova	Mbikëqyrje financiare
Armend	Ademaj	Kosova	Staf
Vasko	Karangeleski	Maqedonia	Panelist - Panel nr. 2
Dejan	Damjanovic	Maqedonia	Panelist - Panel nr. 4
Kiril	Kolemisevski	Maqedonia	Pjesëmarrës
Gordan	Georgiev	Maqedonia	Pjesëmarrës
Dragan	Pulevski	Maqedonia	Staf
Aleksandar	Damjanovic	Mal i Zi	NPC bord + Paneli 1
Zoran	Vukcevic	Mal i Zi	Ekonomi
Mladen	Bojanic	Mal i Zi	Ekonomi
Fatmir	Djeka	Mal i Zi	Ekonomi
Slaven	Radunovic	Mal i Zi	EU
Damir	Davidovic	Mal i Zi	Staf (Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit)
Vladimir	Marinkovic	Serbia	NPC bord + Paneli 1
Jasminka	Roskic	Serbia	Panelist - Panel nr. 2
Miladin	Kovacevic	Serbia	Panelist - Panel nr. 2
Andrijana	Curic	Serbia	Panelist - Panel nr. 3
Aleksandar	Vasilijevic	Serbia	Pjesëmarrës
Vladimir	Milenkovic	Serbia	Pjesëmarrës

Momo	Colakovic	Serbia	Pjesëmarrës
Miodrag	NikolicFeman	Serbia	Pjesëmarrës
Vera	Paunovic	Serbia	Pjesëmarrës
Radojko	Obradovic	Serbia	MP + panelist
Uros	Gostic	Srpska	NPC bord
Mladen	Krstic	Srpska	Ekonomi
Lazar	Mirkic	Srpska	Ekonomi
Dragutin	Skrebic	Srpska	Ekonomi
Branislav	Borenovic	Srpska	BE
Igor	Sekulic	Srpska	Staf
Emil	Atanasovski	Maqedonia	WFD
Marija	Kostovska	Maqedonia	WFD
Damir	Neziri	Maqedonia	WFD
Aleksandar	Stojanovic	Serbia	Pjesëmarrës
Biljana	Ilic	Serbia	Pjesëmarrës
Bosko	Ristic	Serbia	Pjesëmarrës
Dejan	Rajcic	Serbia	Pjesëmarrës
Dragoje	Pavlovic	Serbia	Pjesëmarrës
Dragomir	Karic	Serbia	Pjesëmarrës
Dubravka	Filipovski	Serbia	Deputet
Dusan	Lazic	Serbia	Deputet
Gordana	Comic	Serbia	Pjesëmarrës
Ivan	Bauer	Serbia	Deputet
Jelena	Trivan	Serbia	Pjesëmarrës
Marina	Prilic	Serbia	Pjesëmarrës
Marko	Manojlovic	Serbia	Staf
Milan	Lapcevic	Serbia	Deputet
Nebojsa	Beric	Serbia	Pjesëmarrës
Nikola	Milicevic	Serbia	Pjesëmarrës
Novica	Kulic	Serbia	Pjesëmarrës
Radovan	Raicevic	Serbia	Pjesëmarrës
Slavica	Savic	Serbia	Staf
Slobodan	Peric	Serbia	Pjesëmarrës
Snezana	Paunovic	Serbia	Pjesëmarrës
Velimir	Stanojevic	Serbia	Pjesëmarrës
Vesna	Kovac	Serbia	Deputet
Vesna	Lalovic	Serbia	Staf
Zoran	Andjelkovic	Serbia	Pjesëmarrës
Zoran	Djumic	Serbia	Pjesëmarrës